



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 540, datë 05.11.2020

PËR

KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE NË GJYKATËN E LARTË DHE DHËNIE AUTORIZIMI PËR AKSES NË SISTEMET E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147 të Kushtetutës, dhe neneve 61, 89, të nenit 92 pika 2, dhe nenit 94 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 36 dhe 47 të Ligjit nr. 98/2016 “ Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave të vendimeve gjyqësore të shkallëve më të ulëta, në programin kompjuterik “Word” (Word document), në Gjykatën e Lartë.
2. Dhënien e autorizimit për akses në nxjerrjen e vendimeve nga të dhënat bazë në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) në të gjitha gjykatat e shkallëve të para dhe të gjykatat e apelit, si dhe në Sistemin e Administrimit të Çështjeve Gjyqësore (ARK IT) në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Gjykatës së Lartë, duke u asistuar nga ekspertët teknikë të Misionit EURALIUS V, dhe/ose nga nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas nevojës.
3. Ekspertët e Misionit Euralius V do të kenë akses në sistem, vetëm në praninë (fizike ose “online”) të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Gjykatës së Lartë, si dhe të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të gjykatës nga ku do të merren të dhënat, dhe/ose të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas nevojës.
4. Përpara fillimit të krijimit të kësaj baze të dhënash, të gjithë personat e ngarkuar, detyrohen të nënshkruajnë Deklaratën e Konfidencialitetit.
5. Afati i zbatimit të këtij vendimi është deri në momentin e mundësimit nga ana e sistemit të transferimit elektronik të të dhënave të dosjes, nga një gjykatë në tjetrën.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR